



Qeverisja Vendore dhe Përfshirja Qytetare në projektet rurale në Rusi



Instituti i Kërkimeve Urbane

Konteksti i projektit

Duke konsideruar zbatimin me sukses të buxhetimit me pjesëmarrje në Shqipëri, IKU-it i'u kërkua nga Instituti Urban që të përfshihet dhe asistojë në projektin "Qeverisja Vendore dhe Përfshirja Qytetare në Projektet Rurale në Rusi", nën mbështetjen e WB/CAF dhe në bashkëpunim të ngushtë me OJF-në Ruse, Instituti I Ekonomisë Urbane.

Qëllimi

Qëllimi i projektit është të nxisë një zhvillim me efektiv dhe të barabartë shoqëror-ekonomik në komunitetet rurale nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes vendore dhe përfshirjes qytetare.

Projekti do ta arrijë këtë duke rritur aftësitë drejtuese të liderëve zyrtarë e atyre jozyrtarë dhe duke ndihmuar komunitetet në fuqizimin dhe rritjen e pjesëmarrjes në përfshirjen qytetare. Rajonet pilote të përfshira në këtë projekt janë: PENZA (Noravchatsky, pop. 14,702; Nikolsky, pop. 12,508; Penzensky, pop. 39,103), PERM (Berezovsky, pop. 18,366 Okhansky, pop. 9,640; Cherdynsky, pop. 20,517) dhe Republika e Adygeya (Krasnog vardeisky, pop. 31,536 dhe Maikopsky, pop. 59,658)

Komponenti që mbulon IKU

1. Hartimi/adaptimi i materialeve të trajnimit për kordinatorët lokalë në lidhje me (i) hartimin e buxhetit lokal duke përdorur teknikat e reja pjesëmarrëse e duke u mbështetur në legjislacionin e qeverisjes vendore, dhe (ii) integrimin në jetën e komunitetit të "rregullave të lojës", që do të lejojnë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike (nëpërmjet granteve bashkiake e atyre shoqërore).

- Rishikimi i projektit të planifikimit dhe buxhetimit me pjesëmarrje dhe konceptet kryesore. Kjo përfshiu: Trajnim pesëditor për projektin në përgjithësi, trajnime intensive dhe sesione për planin e punës e grumbullim idesh dhe Takimi i parë me komunitetin–Festivali për vizionin. Ky takim prezantoi komunitetin me procesin e hartimit të buxhetimit me pjesëmarrje, u nxorën objektivat lokal, hapat e veprimit, dhe projektet për investim në mënyre që të plotesohen kërkesat e komunitetit dhe të përfshihen këto kërkesa në buxhet.
- Menaxhimi i performancës dhe rritja e të ardhurave për përmirësimin e shërbimeve publike përfshin: Përpilimi i analizës së situatës – përfshirja e qeverisjes vendore në përpilimin e një kornize analitike për komunitetin dhe përgatitja e një buxheti vjetor. Kjo do t'u mësojë qeverive vendore të përdorin informacionin baze (si p.sh indikatorët social-ekonomikë, vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave/shpenzimeve dhe informacionin për performancën, si p.sh. kënaqësinë e qytetarëve në vlerësimin e shërbimeve të ofruara) për një planifikim sa më real në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.
 - Trajnimi i dytë për qeverisjen vendore/komunitetin – Menaxhimi i performancës dhe shtimi i të ardhurave.
 - Takimi i dytë me komunitetin – Buxhetimi me Pjesëmarrje: Përfshirja qytetare në ofrimin e shërbimeve publike që do të bëjnë prezantimin e rezultateve të punës së grupit të punës mbi analizën e situatës, duke përfshirë

rezultatet e festivalit të vizionit me komunitetin dhe fillimin e prioritizimit të buxhetit duke u bazuar në këtë informacion. Komuniteti do të mësojë se si funksionon buxheti i qeverisjes vendore, alternativat për të gjeneruar të ardhura dhe roli i tyre.

- Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve: Identifikimi i praktikave më të mira dhe replikimi.
- Ndërtimi i të ardhmes sonë: Progresi i bërë për përmirësimin e shërbimeve dhe buxheti 2007.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Charities Aid Foundation (CA)
- ✓ Instituti Urban

KOHËZGJATIA:

Korrik 2005 – Nentor 2006

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti I Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: uri@uri.org.al

Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.